



Kosova

Përshkallëzime
PV diellore të shpërndara
në Kosovë: Analizë e tregut
dhe rekomandime

Toby D. Couture
E3 Analytics

Leartha Hollaj, Dardan Abazi
INDEP

Ky raport është përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe nga kompania Translation Centre në Prishtinë, Kosovë

Përmbajtja

Kosova – profili i vendit	2
1. Hyrje	3
2. Sektori i energjisë elektrike në Kosovë	3
Liberalizimi i tregut	3
Furnizimi dhe konsumi i energjisë elektrike	4
Planet dhe caqet kombëtare për energjinë e ripërtëritshme	5
3. Tregu për gjenerimin e shpërndarë nga burimet solare FV	6
Energjia solare	6
Çmimet e energjisë elektrike për përdoruesit fundorë	7
Politikat aktuale për teknologjinë diellore FV	10
4. Barrierat për teknologjinë diellore FV	15
Politikat dhe rregullimi	15
Matja dhe faturimi	16
Përgjegjësitë e balancimit	17
Mjedisi financiar	17
5. Sinteza dhe rekomandimet	18

KOSOVA — PROFILI I VENDIT	
Popullsia (2018)	1.845.300 ¹
PBB për frymë (2018)	4.302 USD për frymë ²
Konsumi i energjisë elektrike për frymë (2018)	3.157 kWh/vit ³
Cilësia e burimit diellor (rrezatimi solar)	1,400 – 1,500 kWh/m ² /vit
Shkalla e kostove të instaluarave aktuale (e raportuar)	EUR 1.000 – 1.200/kW
Konsumi total vjetor i energjisë (2018)	5.67 TWh
Tarifat mesatare të energjisë elektrike	Ekonomitë familjare: EUR 73/MWh + tatimet Bizneset: EUR 90/MWh + tatimet

Ky hulumtim u mbështet nga Fondacioni Evropian për Klimën (ECF).

¹ <https://data.worldbank.org/country/kosovo>

² Po aty

³ Zyra e Rregullatorit për Energji (2019), Raporti Vjetor për 2018, në dispozicion në <https://www.ero-ks.org/w/shqip/publikimet-mainmenu-110/raportet-vjetore-mainmenu-111>

1. Hyrje

Kosova është në fazën e hershme të procesit të integrimit evropian. Në vitin 2015, Kosova ratifikoi Marrëveshjen e Stabilizimit dhe Asociimit me Bashkimin Evropian dhe aktualisht është duke implementuar këtë marrëveshje. Si pjesë e kësaj, Kosova përfiton nga instrumentet e para-aderimit të Bashkimit Evropian, të cilat synojnë t'i japin shtytje vendit në procesin e integrimit. Nga ana tjetër, Kosova është pjesë e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, i cili synon harmonizimin e politikave në sektorin e energjisë me ato të Bashkimit Evropian, duke synuar përfundimisht integrimin e tregut të energjisë elektrike të Kosovës me atë të rajonit.

Ambicia afatgjatë e BE-së për klimën do të kërkojë dekarbonizimin e plotë të sektorit të energjisë elektrike para vitit 2050, dhe Kosova do të duhet të veprojë në këtë mënyrë. Këto ndryshime të politikave pritet të rezultojnë në zhvendosje të konsiderueshme drejt burimeve të ripërtëritshme në sektorin e energjisë në Kosovë. Sipas verzionit aktual të Strategjisë së Energjisë së Republikës së Kosovës 2017–2026, dekarbonizimi i plotë i sektorit të energjisë në Kosovë pritet të ndodhë deri në vitin 2060. Mirëpo, analiza të ndryshme kanë treguar që ky zotim nuk është mjaftueshëm ambicioz dhe se peizazhi aktual i politikave duhet të ndryshojë për të përshpejtuar dekarbonizimin.⁴

Meqenëse gjenerimi diellor në shkallë të vogël konkurren me çmimet e energjisë elektrike për përdoruesit fundorë në vend të çmimeve të energjisë elektrike me shumicë, teknologjia solare fotovoltaike (FV) mund të jetë investim tërheqës për disa konsumatorë që tani, në varësi të kategorisë së çmimit të tyre të energjisë. Këta investitorë potencialë mbase nuk po konsiderojnë investimet në gjenerimin solar për shkak të barrierave rregullatore dhe teknike për investimet në teknologjinë solare FV në Kosovë.

Prandaj, ky raport përmban një sërë rekomandimesh se si korniza aktuale mund të përmirësohet për të stimuluar investimet në kapacitete solare që montohen mbi çati. Ndërsa raporti është përpiluar duke pasur si synim kryesisht hartuesit e politikave, ai gjithashtu mund të përmbajë njohuri të vlefshme për zhvilluesit si dhe për investitorët e mundshëm në projekte të teknologjisë solare FV me montim mbi çati.

2. Sektori i energjisë elektrike në Kosovë

Liberalizimi i tregut

Sektori i energjisë elektrike në Kosovë ka kaluar nëpër ndryshime të ndjeshme në dekadë duke lëvizur drejt një tregu të liberalizuar, në përputhje me kërkesat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Duke filluar nga viti 2004, sistemi i energjisë elektrike në Kosovë ka ndryshuar nga një sistem i integruar vertikalisht në sistem të shthurur. Prosesi i reformimit më tej ka vazhduar me shthurjen e kompanisë së integruar vertikalisht KEK, në një operator të sistemit të shpërndarjes (i cili tani është privat), një operator të sistemit të transmisionit (KOSTT, që mbetet ndërmarrje private dhe

⁴ INDEP (2017), Rishikim i Strategjisë së Energjisë së Republikës së Kosovës 2017–2026, në dispozicion në https://indep.info/wp-content/uploads/2017/12/Strategjia-e-Energjise-2017-2026_INDEP-dhe-KOSID_RISHIKIM-1.pdf

tani operon si subjekt i veçantë i transmisionit dhe tregut) si dhe nëntë kompani të ndryshme të shërbimeve komunale që janë përgjegjëse për t'u shërbyer konsumatorëve.⁵ Përkundër faktit se Qeveria ka dhënë nëntë liçenca të ndryshme të operimit për ndërmarrje të ndryshme, vetëm njëra prej këtyre liçencave të operimit është aktive, ajo e trashëguar nga KEK.

Si pjesë e procesit të shthurjes në Kosovë, vendi ka themeluar Zyrën e Rregullatorit për Energji. Zyra e Rregullatorit për Energji është organ i pavarur i ngarkuar me rregullimin e veprimtarive në sektorin e energjisë në Kosovë, duke përfshirë energjinë elektrike, ngrohjen qendrore dhe gazin.⁶

Furnizimi dhe konsumi i energjisë elektrike


Miksi energjetik në Kosovë mbetet i mbizotëruar kryesisht nga thëngjilli, ku përafërsisht 97% e miksit total energjetik në vend gjenerohet në termocentralet me thëngjill. **Ky fakt i rrallë e bën Kosovën një nga vendet me pjesën më të madhe të gjenerimit me djegie të thëngjillit në miksin e saj energjetik në mbarë botën.** Përveç gjenerimit me djegie të thëngjillit, vendi ka fare pak energji hidrike, një projekt të vogël të energjisë së erës dhe vlerësohet të ketë 6MW kapacitete të instaluar të teknologjisë solare FV.

Një veçori tjetër e rëndësishme e miksit energjetik është se sektori i banimit (d.m.th. ekonomitë familjare) përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të konsumit të përgjithshëm të energjisë elektrike në vend, me afërsisht 42%.

FIGURA 1: KONSUMI I ENERGJISË PËR LLOJET E NDRYSHME TË KONSUMATORËVE.

Amvisëri	2374	42%
Komercial	944	17%
Industrial	704	12%
Humbje komerciale	755	13%
humbje teknike	674	12%
Transmission Losses	111	2%
Utility Own-Consumption	107	2%
Gjithsej	5669	100%

Burimi: Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE)



Përveç kësaj, kërkesa luhet në mënyrë të konsiderueshme në bazë sezonale, me kulmin e kërkesës në muajt e dimrit (tetor deri në mars), dhe me rënie në periudhën midis prillit dhe gushtit. Pjesërisht si rezultat, Kosova është në gjendje të mbulojë plotësisht kërkesën për energji gjatë muajve të verës, ndërsa pjesërisht kthehet nga importet për të mbuluar kërkesën kombëtare


⁵ Zyra e Rregullatorit për Energji (2015), Raporti Vjetor për 2014, në dispozicion në <https://www.ero-ks.org/w/shqip/publikimet-mainmenu-110/raportet-vjetore-mainmenu-111> (qasur në tetor 2019)

⁶ This Treaty is signed by the European Union and nine partners from South East Europe in Athens in October 2005 on the creation of the legal framework for an integrated energy market. Energy Regulatory Office, (2019), Official Webpage, About ERO, Pristina, available at <https://ero-ks.org/w/shqip/pzrre-extra-menu-75>

gjatë muajve të dimrit. Në 2018, 14.55% e kërkesës për energji u mbulua me importe kryesisht nga vendet fqinje, përfshirë Serbinë, Malin e Zi, Shqipërinë dhe Maqedoninë.⁷

Figura e mësipërme tregon minimumet dhe maksimumet e kërkesës për energji elektrike për ngarkesat ditore në vend, në bazë mujore.

FIGURA 2: MESATARJA MUJORE E KËRKESËS DHE NGARKESAT MAKSIMALE / MINIMALE DITORE 2018



Planet dhe caqet kombëtare për energjinë e ripërtëritshme

Kosova është palë kontraktuese e Traktatit që themelon Komunitetin e Energjisë. Për të mbështetur përdorimin e teknologjive të energjisë së ripërtëritshme në Kosovë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) harton plane afatgjata dhe afatmesme për energjinë e ripërtëritshme në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë. Ministria është gjithashtu përgjegjëse për caktimin e caqeve për energjinë e ripërtëritshme, për monitorimin e implementimit dhe raportimin vjetor për arritjen e caqeve, si dhe për masat e ndërmarra për të arritur caqet. Përveç kësaj, Ministria mund të adoptojë legjislacion dytësor që përmban masa për promovimin e teknologjive të energjisë së ripërtëritshme.⁸

TABELA 1: PASQYRA E CAQEVE TË ENERGISË SË RIPËRTËRITSHME TË KOSOVËS

	I detyrueshëm	Vullnetar
Caku i energjisë nga burimet e ripërtëritshme në konsumin final bruto të energjisë (%) për 2020	25%	29.47%
Totali i parashikuar i konsumit të përshtatur të energjisë më 2020 (ktoe)	1729.82	1729.82
Sasia e parashikuar e energjisë nga burimet e ripërtëritshme që korrespondon me cakun për 2020 (ktoe)	432.46	509.70

⁷ Zyra e Rregullatorit për Energji e Kosovës, (2019), Raporti Vjetor 2018, Prishtinë, në dispozicion në <https://www.ero-ks.org/w/shqip/publikimet-mainmenu-110/raportet-vjetore-mainmenu-111>



⁸ Ministria e Zhvillimit Ekonomik (2013), Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë - PKVBRE 2011-2020, Prishtinë: MZHE.

Qeveria e Kosovës ka adoptuar caqet e mëposhtme për konsumin e saj bruto të energjisë (që përfshin energjinë elektrike, ngrohjen, ftohjen dhe burimet lidhur me transportin) (shih Tabela 1 më poshtë).

Për t'i përmbushur me sukses këto caqe, Kosova ka projektuar një sërë masash dhe politikash, duke përfshirë politikën e tarifave nxitëse (nga gjuha angleze feed-in tariff, shkurt FIT), dispeçimin me prioritet, kornizën e politikave që rregullon vetë-konsumin, si dhe investimet e drejtpërdrejta publike, shpesh në partneritet me donatorët ndërkombëtarë.

Aktualisht, burimet kryesore të energjisë së ripërtëritshme në vend janë hidrocentralet, me disa kapacitete të erës, biomasë dhe ato solare FV. Projektet e energjisë së ripërtëritshme që janë nën pragjet e madhësisë së caktuar janë të pranueshme për politikën shtetërore për tarifa nxitëse, e cila ofron çmime fikse afatgjata për energjinë elektrike të gjeneruar nga burimet e pranueshme (shih Seksionin 3 më poshtë për më shumë detaje).

3. Tregu për gjenerimin e shpërndarë nga burimet solare FV



Energjia solare

Kapaciteti i përgjithshëm i instaluar solar FV në Kosovë aktualisht vlerësohet në 6.6MW. Përveç kësaj, janë edhe 3.4 MW projekte solare FV në ndërtim e sipër, dhe 60 MW projekte me autorizime paraprake në procedurë e sipër. Rezatimi diellor është midis 1400 – 1500 kWh/m²/vit, që është nivel më i lartë se në shumicën e vendeve të BE-së. IRENA (2017) vlerëson se potenciali diellor me kosto konkurruese mund të arrijë afër 600 MW në 2030 në Kosovë.

Duke pasur parasysh faktin se sektori shtëpiak përfaqëson një pjesë të konsiderueshme (42%) të konsumit të energjisë elektrike në Kosovë, gjenerimi i shpërndarë nga burimet solare FV do të mund të luante rol të rëndësishëm në uljen e kërkesës për energji elektrike nga kjo kategori e konsumatorëve, dhe duke bërë këtë, do të luante rol në rritjen e pjesës së energjisë së ripërtëritshme të Kosovës.¹⁰ Përveç kësaj, sektori industrial dhe tregtar gjithashtu ka potencial të madh për gjenerimin e shpërndarë nga burimet solare FV dhe disa konsumatorë tregtarë dhe industrialë kanë filluar të demonstrojnë interesim për të investuar në sisteme diellore FV në lokacion.


⁹ Harta Globale Solare, Worldbank dhe Solargis, në dispozicion në <https://solargis.com/maps-and-gis-data/download/kosovo>

¹⁰ Po aty

Çmimet e energjisë elektrike për përdoruesit fundorë

Çmimet mesatare të energjisë elektrike, si ato shtëpiake ashtu edhe ato jo-shtëpiake, janë rritur me kalimin e kohës.¹¹ Mirëpo, figura më poshtë tregon se kjo rritje ka qenë mjaft e moderuar ku çmimet e energjisë elektrike janë rritur vetëm me afërsisht 7% gjatë pesë viteve të fundit. Ky trend në rritje i çmimeve për përdoruesit fundorë, i kombinuar me uljen e kostos së energjisë diellore, do të rezultojë që energjia diellore të bëhet një mundësi investimi gjithnjë e më tërheqëse, veçanërisht për konsumatorët që paguajnë çmime më të larta (p.sh. bizneset).

FIGURA 4: ÇMIMET MESATARE TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR KONSUMATORËT SHTËPIAKË DHE JO-SHTËPIAKË



KUTIA 1: EFEKTI I ÇMIMIT TË SHITJES ME PAKICË PËR KONSUMATORËT-PRODHUES SOLARË

Si struktura ashtu edhe niveli i çmimit të energjisë elektrike me pakicë kanë efekt të ndjeshëm në atraktivitetin e projekteve diellore FV në lokacionin e konsumatorëve.

Sa më i lartë të jetë çmimi i shitjes me pakicë, aq më tërheqëse janë investimet në teknologjitë e vetë-gjenerimit siç janë kapacitetet diellore FV. Duke patur parasysh që kostoja e ponderuar e investimeve në teknologjinë diellore FV me montim në çati është tani nën 100 EUR/MWh në shumicën e tregjeve në mbarë botën, përfshirë në vendet si Kosova, çmimet e shitjes me pakicë në këtë gamë dhe mbi të konsiderohen zakonisht të mjaftueshme për të nxitur investime. Në fakt, analiza e fundit e shteteve të ndryshme në mbarë SHBA tregon se çmimet e shitjes me pakicë janë më shumë me rëndësi sesa cilësia e burimeve diellore në përcaktimin se ku do të bëhen investimet në lokacion të konsumatorit.¹

Mirëpo, përveç çmimeve të shitjes me pakicë është e rëndësishme të merret parasysh struktura e çmimeve të shitjes me pakicë: për shembull, futjen e bllok-tarifave (ku çdo kWh shtesë i konsumuar bëhet më i shtrenjtë) kanë tendencë që t'i bëjnë më tërheqëse investimet e vetë-konsumit, meqenëse së pari reduktohen pjesët më të shtrenjta të konsumit, duke mundësuar norma më të larta të kthimit. Në mënyrë të ngjashme, prania e tarifave të kërkesës (të cilat zakonisht vendosen për-kWh sipas kërkesës maksimale elektrike që konsumatori i caktuar e arrin në një cikël të veçantë faturimi) gjithashtu mund t'i bëjë më tërheqëse projektet diellore

¹¹ Zyra e Rregullatorit për Energji, (2019), Raportet Vjetore për 2010–2018, Prishtinë: ZRRE

FV, veçanërisht kur shoqërohen me depozitim, meqë depozitimi mund të garantojë që pragjet e caktuara të kërkesës nuk arrihen kurrë.

Përveç kësaj, faktorët e tillë si pagesa e faturave fikse, tatimet ose tarifat e veçanta të subvencioneve, gjithashtu mund ta bëjnë më tërheqës vetë-konsumin, meqë ato shtyjnë rritjen e çmimeve të shitjes me pakicë.

¹ <https://energyathaas.wordpress.com/2020/02/03/putting-solar-in-all-the-wrong-places/>

Struktura e tarifave të energjisë elektrike në Kosovë pësoi një sërë ndryshimesh në vitin 2017. Me ndryshimet e tarifave, u eliminuan bllok tarifat. Para vitit 2017, konsumatorët që shpenzonin më pak se 200 kWh në muaj paguanin tarifë më të ulët në krahasim me ata që konsumonin midis 200-600 kWh dhe mbi 600 kWh. Tani të gjithë konsumatorët paguajnë tarifa të sheshta, pavarësisht se sa energji elektrike konsumojnë brenda muajit.

Zyra e Rregullatorit për Energji e justifikoi vendimin duke thënë se kjo do të thjeshtojë faturën dhe do të jetë një hap i mëtejshëm në procesin e liberalizimit të tregut dhe de-rregullimit të çmimeve. Sidoqoftë, disa nga organizatat e shoqërisë civile të Kosovës kundërshtuan ndryshimet e tilla, duke argumentuar se ndryshimi do të rrisë konsumin, do të dekurajojë kursimin e energjisë dhe do të rrisë varfërinë e energjisë.¹² Përveç kësaj, kjo do të ketë ndikime të drejtpërdrejta në atë se sa tërheqëse do të jenë investimet në teknologji diellore FV në lokacion të konsumatorit, meqë çmimet rritëse të bllok tarifave e bëjnë më tërheqëse për ekonomitë familjare dhe bizneset me konsum më të lartë të energjisë elektrike që të investojnë në furnizim në lokacionin e konsumatorit. Përderisa bllok tarifat tashmë janë braktisur, tarifat e rishikuara të energjisë elektrike e kanë ruajtur diferencimin sipas kohës së shpenzimit. Struktura aktuale e çmimeve të energjisë për kategoritë e ndryshme është paraqitur në Tabelën 2.

TABELA 2: PASQYRA E ÇMIMEVE TË ENERJISË ELEKTRIKE NË KOSOVË SIPAS LLOJIT TË KONSUMATORIT DHE KOHËS SË SHPENZIMIT

Niveli i tensionit	Njësia	Koha e shpenzimit	Çmimi (EUR/MWh)
35kV	EUR/MWh	Natën	31.6
		Ditën	49.2
10 kV	EUR/MWh	Natën	36.9
		Ditën	57.3
0.4 kV (Kategoria I - Konsumatorët me energji reaktive)	EUR/MWh	Natën	49.6
		Ditën	66.9
0.4 kV (Kategoria II)	EUR/MWh	Natën	53
		Ditën	107.1
0.4 kV njehsori me 2-tarifa (shtëpiak)	EUR/MWh	Natën	28.9
		Ditën	67.5
0.4 kV njehsori me 1-tarifë (shtëpiak)	EUR/kWh	Natën	17.4
		Ditën	53.2
0.4 kV ekonomitë familjare pa njehsorë me kohën e shpenzimit	EUR/kWh	Fikse	67.5


* Tarifa e ulët e natës vlen nga 22:00-07:00.

¹² INDEP, (2017), Analizë e Strukturës së re Tarifore të propozuar nga ZRRE, në dispozicion në (ALB version) <https://indep.info/wp-content/uploads/2017/03/Analiza-për-strukturen-tarifore-te-ZRRE.pdf> (qasur në dhjetor, 2019)

KUTIA 2: KUPTIMI I RAPORTIT TË VETË-KONSUMIT NGA PROSUMATORËT

ëRaporti i vetë-konsumit i referohet pjesës (%) së gjenerimit total nga kapacitetet diellore FV të një prosumatori, që ai është në gjendje, mesatarisht, ta konsumojë në “kohë reale” brenda muajit ose vitit të caktuar. Konsumatorët shtëpiakë që investojnë në sistemin e vet diellor FV zakonisht kanë raporte të vetë-konsumit midis 20-40%.¹ Përkundrazi, raporti i vetë-konsumit për konsumatorët tregtarë tregon një gamë më të gjerë që ka tendencë të jetë disi më e lartë, midis 50-70%, varësisht nga profili i ngarkesës së konsumatorit tregtar dhe madhësisë së sistemit FV që është i instaluar.²

FIGURA 5: PASQYRA E RAPORTIT TË VETË-KONSUMIT PËR KONSUMATORËT SHTËPIAKË DHE TREGTARË (ILUSTRUES)



Në fakt, çdo prosumator mund të arrijë profil vetë-konsumi prej 100% thjesht duke instaluar një vargan të vogël diellor FV, duke siguruar kështu që i tërë gjenerimi i energjisë (ose pjesa më e madhe e tij) në kohë reale mund të konsumohen drejtpërdrejt në ndërtesën, ose objektin ku ndodhet. Ky është rasti nëse madhësia e instalimit FV është e tillë që prodhon energji elektrike ekuivalente me ngarkesën minimale të ditës për ekonominë familjare.

Për shembull, analizat e bëra te konsumatorët e ndryshëm tregtarë tregojnë se një fermë qumështore me kërkesë vjetore të energjisë elektrike prej 50.000 kWh dhe sistem FV prej 30 kW mund të arrijë raport vetë-konsumi prej përafërsisht 55%. Për dallim nga kjo, për një biznes prodhues që operon kryesisht gjatë ditës me kërkesë prej 1.000.000 kWh dhe sistem PV prej 200 kW, raporti i arritshëm është përafërsisht 85 për qind.²

Dallimet në raportin e vetë-konsumit të prosumatorëve të ndryshëm mund të kenë efekt të ndjeshëm në atraktivitetin e investimeve në teknologji diellore FV. Për shembull, në juridiksione me çmime relativisht të larta të shitjes me pakicë dhe politika të dobëta (ose pa to fare) që rregullojnë gjenerimin e tepërt neto, shumë prosumatorë thjesht zgjedhin madhësinë e sistemeve të tyre PV sipas ngarkesës së tyre minimale të ditës. Në këtë mënyrë, ata mund të shmangin gjenerimin e konsiderueshëm të tepërt neto. Në juridiksione me kushte më tërheqëse për eksportimin e energjisë, konsumatorët mund të zgjedhin të përdorin edhe më shumë sipërfaqen e disponueshme të çatisë dhe të instalojnë sisteme FV më të mëdha, duke eksportuar tepërcën në rrjet , duke arritur kështu raport më të ulët të përgjithshëm të vetë-konsumit.

¹ <https://www.sma.de/en/partners/knowledgebase/the-self-consumption-bonus.html>

² <https://www.sma.de/en/partners/knowledgebase/commercial-self-consumption-of-solar-power.html>

Aktualisht, duke pasur parasysh pranimin e tarifës nxitëse për projektet diellore në Kosovë, ka gjasë që shumë prosumatorë potencialë të përcaktohen për tarifën FIT (d.m.th. për injektim 100% të energjisë elektrike të tyre të gjeneruar në rrjet, në vend se ta vetë-konsumojnë një pjesë të saj), siç ishte rasti në Gjermani deri në vitin 2012–2013. Sidoqoftë, ndërsa çmimet e shitjes me pakicë në Kosovë vazhdojnë të rriten, dhe disponueshmëria e tarifave FIT bëhet më e kufizuar, një numër në rritje i konsumatorëve ka të ngjarë të fillojnë ta konsiderojnë tërheqës vetë-konsumin, veçanërisht meqë çmimet e teknologjisë diellore FV vazhdojnë të bien.

Politikat aktuale për teknologjinë diellore FV

Prodhimi i energjisë së ripërtëritshme subvencionohet me tarifë nxitëse. Aktualisht, tarifën nxitëse diferencohen për nga teknologjia si më poshtë:

- energjia e ujit (hidrocentralet e vogla): 67,3 EUR/MWh
- energjia e erës: 85 EUR/MWh
- energjia nga biomasa: 71,3 EUR/MWh
- energjia diellore FV: 136,4 EUR/MWh¹³

Tarifat FIT për projektet solare FV ofrojnë pagesa të garantuara për periudhë 12-vjeçare. Përveç kësaj, sipas rregulloreve aktuale në Kosovë, nga operatorët e sistemit të transmissiionit dhe shpërndarjes kërkohet t'i japin **dispeçim me prioritet** gjenerimit nga burimet e energjisë së ripërtëritshme në përputhje me kufijtë e specifikuar në Kodin e Rrjetit të vendit. Nga ana tjetër, operatori i sistemit lejohet të krijojë dhe publikojë rregulla në lidhje me atë se kush do të bartë kostot për çdo adaptim teknik dhe investime në nivel të rrjetit që janë të nevojshme për të lehtësuar integrimin e burimeve të energjisë së ripërtëritshme në sistem, megjithëse rregullat e tilla duhet të miratohen nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE).

Zyra e Rregullatorit për Energji siguron që tarifën e transmetimit dhe shpërndarjes për prodhuesit e energjisë së ripërtëritshme janë jo-diskriminuese. ZRRE është gjithashtu organi përgjegjës për lëshimin e certifikatave të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burime të energjisë së ripërtëritshme.¹⁴

Përveç politikës së saj për tarifën FIT, në Kosovë është prezantuar **Matja Neto**. Sipas kësaj kornize, politika ofron kreditim në faturim për çdo kWh të energjisë elektrike tepërcë të injektuar në rrjet, duke lejuar konsumatorin që ta bartë atë kWh në ciklet e mëpasshme të faturimit. Kështu, çdo mosbalancim pozitiv kreditohet me energji elektrike përmes kreditimit në faturim për-kWh, në vend të pagesës me para (shiko Kutia 3 më poshtë për më shumë informacion). Në mënyrë që të jenë të pranueshëm për të marrë pjesë në këtë skemë, konsumatorët duhet të jenë të lidhur me rrjetin në nivele të tensionit prej 0,4kV, duke e kufizuar programin kryesisht për ekonomitë familjare dhe kompanitë shumë të vogla.

Më konkretisht, Kreu V në Rregullën nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë krijon skemën për mbështetjen e gjeneratorëve të vetë-konsumit (konsumatorëve prodhues). Korniza e politikave që rregullon vetë-konsumin në Kosovë parashikon që:

¹³ Republika e Kosovës, (2017), Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2017–2026, në: Gazeta zyrtare

¹⁴ Po aty

- Furnizuesit e marrin gjithë energjinë elektrike të prodhuar dhe e dërgojnë gjithë energjinë elektrike të konsumuar nga prosumatorët brenda Periudhës së Faturimit (d.m.th. një muaj);
- Furnizuesit llogarisin Bilancin e Prosumatorit për Periudhën e Faturimit, në bazë të të cilit përgatitet fatura mujore;
- Nëse Bilanci i Prosumatorit është pozitiv, atëherë Prosumatori kreditohet me energji (në kWh) në Periudhën e Faturimit që vijon;
- Çdo Bilanc pozitiv i papaguar në Periudhën e Faturimit të fundit brenda vitit kalendarik rivendoset në zero (0 kWh) pa kompensim nga Furnizuesi;
- Nëse Bilanci i Prosumatorit është negativ, atëherë Furnizuesi faturon Prosumatorin për vlerën e Bilancit të Prosumatorit.¹⁵

KUTIA 3: OPSIONET PËR ÇMIMIN DHE SHITJEN E GJENERIMIT TË TEPËRT NETO

Në kuptim të gjerë, ekzistojnë tri metodologji të ndryshme për caktimin e çmimit që përdoren për të përcaktuar kompensimin për gjenerimin e tepërt neto të prosumatorëve:

1. **Kompensimi me kreditim në faturim (d.m.th. në kWh)** që mund të bartet për të kundërbalancuar, në bazën kWh-kWh, konsumin e energjisë elektrike të subjektit në ciklet e ardhshme të faturimit (Matja Neto)
2. **Kompensimi me kreditim monetar (p.sh. 1 kWh = 0,06 EUR)** që mund të bartet për të reduktuar faturën e energjisë elektrike në ciklet e ardhshme të faturimit (Faturimi Neto)
3. **Kompensimi me pagesë monetare (d.m.th. EUR cent/kWh)**, ku konsumatori merr edhe një çek edhe një faturë në fund të çdo cikli të faturimit (FIT-Neto)

Për më tepër, ekziston çështja e rëndësishme se si përcaktohen këto norma. Për Matjen Neto, kjo është e thjeshtë: çdo kWh i eksportuar në rrjet gjeneron kreditim prej një kWh që mund të përdoret për të kundërbalancuar konsumin e ardhshëm. Mirëpo, **si për Faturimin Neto ashtu edhe për FIT-Neto, ka konsiderata plotësuese që duhet të merren parasysh**; në këto raste, ekzistojnë pesë opsione themelore për përcaktimin e çmimit të ofruar për gjenerimin e tepërt neto:

1. **lidhur me tregun në kohë reale** (megjithëse kjo do të kërkonte njehsorë të kohës së përdorimit për të gjithë konsumatorët dhe ka gjasë të paraqesë pengesë shtesë për klientët shtëpiakë dhe konsumatorët e vegjël tregtarë);
2. **lidhur me tregun**, por bazuar në mesataret ditore, mujore ose vjetore;
3. **lidhur me komponentin energjetik të normës së shitjes me pakicë**, minus një tarifë e vogël, ose përqindje, për të mbuluar kostot e transaksionit dhe marzhën e furnizuesit (p.sh. 10-15%);
4. **Bazuar në ndonjë normë tjetër**, siç janë kostot e energjisë të shmangura nga furnizuesi, që rishikohen dhe azhurnohen me kalimin e kohës;
5. **Bazuar në ndonjë formulë tjetër**, siç është vlera e energjisë diellore në rrjetin e shpërndarjes, pasi të jetë marrë parasysh koha e ditës, reduktimi i humbjeve të linjës, vlera e energjisë dhe kapacitetit, etj.

Secili prej këtyre opsioneve të ndryshme ka implikime të rëndësishme si për furnizuesit (d.m.th. blerësit), ashtu edhe për prosumatorët.

¹⁵ Zyra e Rregullatorit për Energji, (2011), Rregulla nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë, Kreu V, në dispozicion në http://www.ero-ks.org/2017/Rregullat/Rule%20on%20Support%20Scheme_2017.pdf (qasur në tetor 2019)

Një tjetër konsideratë e rëndësishme për politikëbërësit dhe rregullatorët është nëse rregulla të ndryshme dhe kushte të ndryshme të pagesës vlejné për projekte të madhësive të ndryshme, për konsumatorët shtëpiakë kundrejt atyre tregtarë, për konsumatorët e lidhur në nivele të ndryshme të tensionit, ose për konsumatorët në kategori të ndryshme të normave.

Në SHBA, me larminë më të madhe të politikave të Matjes Neto, Matja Neto zakonisht rezervohet për projekte me madhësi më të vogël nën 1-2 MW.¹ Për dallim nga kjo, Brazili rishtas ngriti tavanin e madhësisë së projektit në projektet e Matjes Neto deri në 5 MW.² Në disa raste, ka aranzhime të ndryshme të pagesës që janë në dispozicion për projekte të madhësive të ndryshme.

Në përgjithësi, sa më të mëdha që të bëhen projektet e gjenerimit që janë të kyçura, aq më shumë ka të ngjarë që projektet e tilla të marrin **pagesa monetare** të ndonjë forme për gjenerimin e tyre të tepërt neto (d.m.th. një FIT-Neto), për dallim nga sistemet më të vogla me montim në çati, të cilat vazhdojnë të operojnë kryesisht në bazë të **kreditimit në faturim** (si te Matja Neto), ose me **kreditim monetar** (p.sh. si te Faturimi Neto).


Në interes të mbajtjes së politikave të vetë-konsumit në nivel të thjeshtë dhe të lehtë për t'u kuptuar si për prosumatorët ashtu edhe për furnizuesit, disa juridiksione zgjedhin të zbatojnë të njëjtat rregulla të kompensimit për të gjithë prosumatorët, pavarësisht nga madhësia e projektit ose kategoria e normës së konsumatorit.


¹ <https://programs.dsireusa.org/system/program>

² <https://www.pv-magazine.com/2018/01/24/brazil-surpasses-175-mw-of-solar-under-net-metering/>

Ndërsa kjo Rregullore është në fuqi, **nga viti 2017 deri në fillim të vitit 2020, janë lëshuar 20 leje për ndërtimin e projekteve diellore FV të konfiguruar për vetë-konsum.**

Çdo konsumator i energjisë elektrike i lidhur me rrjetin e shpërndarjes së tensionit të ulët (0,4 kV) mund të aplikojë te furnizuesi i tyre për marrjen e statusit të **konsumatorit prodhues**. Janë tre hapa kryesorë që duhet të ndiqen nga gjeneratorët e energjisë së ripërtëritshme për të marrë liçencat dhe lejet e nevojshme: autorizimi paraprak, autorizimi përfundimtar dhe kyçja në rrjet. Figura më poshtë jep pasqyrën e këtij procesi të lejimit:





Burimi: Ministria e Zhvillimit Ekonomik e Republikës së Kosovës

Përveç kësaj, në vitet e fundit ka pasur paqartësi në lidhje me trajtimin e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH), dhe nëse TVSH do të duhej të shtohet në energjinë elektrike të injektuar në rrjet. Në tetor të vitit 2019, Ministria e Financave u angazhua të ofrojë qartësi për prosumatorët në Kosovë në lidhje me këtë çështje: udhëzimi tani kërkon që prosumatorët të lëshojnë faturë për energjinë elektrike që ata e injektojnë në sistem që përfshin llogaritjen e TVSH-së (aktualisht e caktuar në 16%). Ky është një gjest mjaft simbolik në këtë moment duke marrë parasysh faktin se sipas Ligjit nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, TVSH-ja mund të rimbursohet në fund të vitit. Duke pasur parasysh pragun e ulët për pjesëmarrje të paraparë me politikën për Matje Neto (për konsumatorët e lidhur në nivelin e tensionit 0,4kV), shumat e TVSH-së në fjalë do të ishin të vogla (shih Kutia 4 më poshtë për trajtimin e TVSH-së).

KUTIA 4: PROSUMATORËT DHE TRAJTIMI I TVSH-SË

Në kuptimin e gjerë, ekzistojnë tri forma kryesore të tatimit që janë relevante për autoritetet tatimore, dhe që do të duhej të merren parasysh:

- TVSH që ngarkohet për pajisje** (panele, invertorë, instalime elektrike, etj.): kjo vazhdon të arkëtohet përveç nëse vendosen përjashtime të veçanta nga autoritetet përgjegjëse tatimore dhe ofron të hyra të drejtpërdrejta tatimore për qeverinë në vitin 0.
- TVSH që ngarkohet për operim, mirëmbajtje dhe kostot e sigurimeve:** për të gjitha aspektet që lidhen me shërbimin, përfshirë mirëmbajtjen, sigurimet, etj., qeveria do të vazhdojë të arkëtojë TVSH-në, sipas rastit, gjatë ciklit jetësor të aktivitetit.
- TVSH për energjinë elektrike të eksportuar:** Kur prosumatori eksporton energji elektrike, kjo zakonisht trajtohet si “mall ose shërbim”, prandaj i nënshtrohet TVSH-së. Kur gjenerimi i tepërt neto i është shitur një ndërmarrjeje të shërbimeve komunale, si biznes, kjo e fundit zakonisht mund ta rikuperojë TVSH-në. Dhe nëse prosumatori është ekonomi familjare, ai zakonisht nuk ka të drejtë të arkëtojë TVSH, përveç nëse regjistrohet si person juridik i regjistruar për TVSH.
- TVSH që ngarkohet për energjinë elektrike të importuar (të blerë):** Çdo tatim që e paguan prosumatori në blerjet e tij të energjisë elektrike zakonisht reduktohet në mënyrë vëllimetrike nga vetë-konsumi. Meqenëse tatimet zakonisht ngarkohen mbi konsumin “neto” në muajin e caktuar, ose në ciklin e faturimit, reduktimi i blerjeve nga rrjeti do të rezultojë në reduktim

të TVSH-së totale që paguhet. Kjo mund të rezultojë në humbje të TVSH-së për qeverinë, veçanërisht gjatë ciklit jetësor së aktivitetit.

Nga lista e mësipërme, është kategoria e katërt e tatimit të TVSH-së që mbase është më problematike. Analizat e kryera nga Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë kanë treguar që në shumicën e rasteve të modeluara, humbja neto e të hyrave tatimore në lidhje me TVSH-në është reale, por e vogël.² Përveç kësaj, nëse të hyrat që rrjedhin nga eksporti i gjenerimit të tepërt neto në rrjet rezultojnë në përfitim financiar ose fitim, atëherë autoritetet përkatëse tatimore janë përgjegjëse për ta ngarkuar tatimin mbi të ardhurat nga fitimi shoqëruar.

¹ https://www.energy-community.org/dam/jcr:b73594c1-0e30-48bc-aac1-e8b7ce1478d7/WSEL052017_Muratovi%C4%87_recommendations.pdf

² https://nachhaltigwirtschaften.at/resources/iea_pdf/reports/iea_pvps_task1_review_and_analysis_of_pv_self_consumption_policies_2016.pdf

Shitja e energjisë elektrike nga gjeneratorët që nuk janë ndërmarrje të shërbimeve komunale në Kosovë mbulohet me Marrëveshje të Blerjes së Energjisë Elektrike (MBE); kjo MBE duhet të lidhet ndërmjet Gjeneruesit me BRE dhe Operatorit të Tregut. Në Kosovë, energjia elektrike e prodhuar nga gjeneratorët me BRE gëzon dispeçim me prioritet. Operatori i Tregut është i detyruar të nënshkruajë marrëveshje MBE për të blerë energjinë elektrike qoftë me tarifat nxitëse të caktuara nga qeveria, ose me ndonjë çmim tjetër referues; në rastin e fundit, çmimi përcaktohet çdo vit nga Zyra e Rregullatorit për Energji.¹⁶ Që nga prilli i vitit 2020, ende nuk është marrë vendim për të caktuar çmimin referues për vitin 2020.

Përveç kësaj, projektet e vogla dhe të mëdha të energjisë së ripërtëritshme që nuk janë pjesë e skemës mbështetëse mund ta shesin prodhimin e tyre të energjisë elektrike qoftë sipas Kornizën së rregulluar ose sipas kushteve të bazuara në treg.¹⁷ Sipas kushteve të bazuara në treg, ato mund t'i shesin blerësve të gatshëm për bashkëpunim në varësi të kushteve dhe çmimeve të tregut, ndërkohë që vazhdojnë të gëzojnë dispeçimin me prioritet. Tabela 3 më poshtë jep pasqyrën e politikave dhe rregulloreve kryesore të disponueshme për projektet diellore FV në Kosovë.

TABELA 3: POLITIKAT DHE RREGULLORET PËR TEKNOLOGJINË DIELLORE FV NË KOSOVË

	Brenda Skemës Mbështetëse	Jashtë Skemës Mbështetëse (Korniza e rregulluar)	Jashtë Skemës Mbështetëse (Kushtet e bazuara në treg)
Dispeçim me prioritet	Po	Po	Po
Përgjegjësia e kostove të mosbalancimit	25%	Po, përveç për gjeneratorët me kapacitet nën 500 kW	Po, përveç për gjeneratorët me kapacitet nën 500 kW
Shitja e energjisë elektrike përmes Marrëveshjes së Blerjes së Energjisë Elektrike (MBE)	Po, MBE do të duhej të jetë për periudhë 12-vjeçare.	Po, MBE do të duhej të jetë për periudhë 1-vjeçare, të paktën ¹⁸	Po, MBE do të duhej të jetë për periudhë 1-vjeçare
Tarifa nxitëse	Po	Jo, çmimi referues caktohet çdo vit nga ZRRE.	Jo, çmimet përcaktohen nga rregullat e tregut.

¹⁶ Ibid, article 15.

¹⁷ Ibid

¹⁸ Zyra e Rregullatorit për Energji, (2011), Rregulla nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë, në dispozicion në http://www.ero-ks.org/2017/Rregullat/Rule%20on%20Support%20Scheme_2017.pdf (qasur në tetor 2019)

4. Barrierat për teknologjinë diellore FV

Ekzistojnë disa pengesa për zhvillimin e projekteve për gjenerimin e shpërndarë nga burimet diellore FV në Kosovë. Barrierat ndahen në katër kategori: 1) Politikat dhe rregullimi, 2) Matja dhe faturimi, 3) Përgjegjësitë e balancimit, dhe 4) Financimi.

Politikat dhe rregullimi

Vonesa të gjata administrative dhe për leje: Disa nga pengesat kryesore lidhen me faktin se periudha nga autorizimi paraprak deri në autorizimin përfundimtar është shumë e gjatë dhe mund të zgjasë deri në tre vjet. Disa kompani aplikojnë për skemën mbështetëse dhe u alokohen disa kapacitete, por ato nuk janë në gjendje ta kryejnë implementimin sipas këtij afati fillestar. Kjo çon në mospërputhje ndërmjet autorizimeve paraprake dhe investimeve aktuale në terren. ZRRE aktualisht është duke bërë përpjekje për ta adresuar këtë çështje duke propozuar periudha më të shkurtra ku nga kompania që ka autorizim paraprak kërkohet të implementojë projektin ose të humbasë statusin e investitorit potencial.

Kufizimet arbitrare të imponuara për prosumatorët: Aktualisht, për të marrë pjesë në kornizën e politikave dhe atë rregullatore të ofruar për prosumatorët, konsumatorët duhet të jenë të lidhur me rrjetin në nivele të tensionit prej 0,4 kV. Kjo kufizon ndjeshëm tregun potencial për projekte diellore FV në lokacion të konsumatorit dhe veçanërisht për vetë-konsum, meqë shumë nga konsumatorët për të cilët projektet e tilla janë më tërheqëse janë konsumatorë tregtarë dhe industrialë. Heqja e kufirit të pragut të tensionit deri në 35 kV do të mundësonte pjesëmarrjen e një game më të gjerë të konsumatorëve.

Kërkesat e veçanta për pëlqimin komunal për të zhvilluar projekte diellore FV: Nga komunat në Kosovë kërkohet të japin formularë pëlqimi për projektet e gjenerimit të shpërndarë nga burimet diellore. Këto janë dokumente zyrtare në të cilat komuna deklaron se projekti përkatës nuk e pengon implementimin e planeve zhvillimore komunale ose planeve urbanistike dhe se projekti nuk rrezikon ndonjë strukturë ndërtimi. Dokumenti kërkohet për projektet që implementohen në çdo pjesë të territorit komunal, pavarësisht nëse është zonë urbane apo rurale. Për komunat, ky dokument është plotësisht i ri dhe për këtë arsye ato nuk janë shumë të familjarizuara me të, veçanërisht me mënyrën si ai lëshohet për projektet diellore. Kjo shkakton vonesa të panevojshme për investitorët të cilët dëshirojnë të investojnë në projekte për gjenerimin e shpërndarë nga burimet diellore FV, si dhe për konsumatorët që mbase janë të interesuar të bëhen prosumatorë.

Mjedisi nganjëherë jofunksional institucional dhe rregullator: Në Zyrën e Rregullatorit për Energji ka mbizotëruar emërimi i personave në bazë të prirjeve politike dhe partiake. Sipas legjislacionit aktual, është Qeveria ajo që propozon anëtarët për Bordin e Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe Kuvendi i Kosovës i miraton propozimet. Përveç kësaj, emërimi bëhet në bllok për të gjitha pozitat e lira. Kjo ka bërë që partitë në pushtet të zgjedhin kandidatët që ishin anëtarë të partisë ose të lidhur ngushtë me partitë politike në pushtet. Meqenëse koalicioni qeveritar herë pas here përbëhet nga deri në pesë parti politike, shpesh ka mosmarrëveshje për emrat e propozuar, gjë që çon në vonesa. Në raste ekstreme, kjo mund ta bëjë ZRRE-në jofunksionale për shkak të

¹⁹ European Commission, (2019), Kosovo Report, Existence of a functioning market economy, page 41, available at <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-kosovo-report.pdf> (accessed in December, 2019)

skadimit të mandatit të anëtarëve të bordit. Një sistem më meritokratik, ku theksohen kriteret profesionale dhe të emëruarit votohen individualisht, me rotacion të bazuar në mandate me kohëzgjatje të ndryshme, është një nga zgjidhjet e propozuara nga grupet e shoqërisë civile në vend. Sipas qasjes së tillë, çdo vit, një nga pesë anëtarët e ZRRE-së do të duhej të emërohej përmes një procesi konkurrues dhe transparent, së bashku me kriteret të rrepta profesionale për të siguruar pavarësinë, efektivitetin dhe profesionalizmin e ZRRE-së.

Mungesa e krahut të kualifikuar të punës: Në kuptimin e gjerë, Kosova nuk ka bërë sa duhet për të projektuar programe trajnimi për instalimin, mirëmbajtjen dhe sigurimin e cilësisë së paneleve diellore. Kosova ka sistem tejet funksional për arsimin dhe trajnimin profesional që lehtësisht mund të adoptojë programet e tilla të trajnimit me qëllim të krijimit të krahut të kualifikuar të punës.

Matja dhe faturimi

Për të përcjellë progresin drejt arritjes së caqeve të energjisë së ripërtëritshme të Kosovës, nevojiten të dhëna të sakta. Në veçanti, këtu përfshihen të dhënat për prodhimin bruto të sistemeve diellore FV. Nëse matet vetëm gjenerimi neto që del nga impianti, kjo nuk e llogaritëgjenerimin solar që prodhohet dhe konsumohet në lokacion të konsumatorit. Si rezultat, është e rëndësishme që vendet të sigurojnë që prosumatorët të kenë infrastrukturën e duhur për matje në mënyrë që të monitorojnë zhvillimin e brendshëm të energjisë së ripërtëritshme drejt arritjes së caqeve

KUTIA 5: KONSIDERATA PLOTËSUESE RRETH MATJES

Marrëveshjet e disponueshme për matje (ose të përcaktuara nga shërbimet komunale) në një juridiksion të caktuar mund të kenë efekte të drejtpërdrejta në atraktivitetin e vetë-konsumit:

- **Në mungesë të njehsorëve në dy-kahe dhe të kompensimit të qartë për gjenerimin e tepërt neto,** atëherë tendenca do të jetë që sistemet FV të shkojnë drejt mbulimit të konsumit vetjak të konsumatorëve në nivelin më të ulët të ngarkesës gjatë ditës. Kjo mund të rezultojë në sisteme FV relativisht të vogla që instalohen në çati të mëdha tregtare dhe dështim për të shfrytëzuar potencialin e disponueshëm për montim në çati.
- **Në situatat kur përdoren matës në dy-kahe, por nuk ofrohet kompensim në para, vetëm kreditim në faturim** (d.m.th. sipas Matjes Neto), prosumatorët mund të zgjedhin të maksimizojnë madhësinë e sistemit FV, veçanërisht nëse ata paguajnë çmime mbi mesataren e shitjes me pakicë. Kjo mund të çojë në sasi të konsiderueshme të gjenerimit të tepërt neto, mbi dhe përtej asaj që shërbimet komunale presin nga prosumatorët.
- **Nëse do të ketë njehsorë me dy-kahe dhe prosumatorët do të mund të shesin energjinë elektrike në kohë reale** (d.m.th. Sipas Faturimit Neto), atëherë ka gjasë që prosumatorët të zgjedhin madhësinë e sistemit të tyre më me kujdes, duke qenë të vetëdijshëm se raporti i tyre i vetë-konsumit dhe norma e pritshme e eksportit do të kenë efekt të ndjeshëm në rentabilitetin e tyre; mirëpo, çmimi i ulët me të cilin mund të shitet energjia elektrike mund të jetë barrierë dhe prapë mund të rezultojë që prosumatorët të përcaktohen për sisteme të madhësisë më të vogël, në mënyrë që të shmangin sasinë e madhe të gjenerimit të tepërt neto.

Në fund të fundit, duhet të merret vendimi nëse Kosova dëshiron të inkurajojë investimet e mëtejshme në teknologji diellore dhe në çfarë mase. Sidoqoftë, është e qartë se edhe pa mbështetje ka hapësirë për investime shtesë në radhët e grupeve që paguajnë çmime të larta dhe kanë norma të larta të vetë-konsumit.

kombëtare të energjisë dhe klimës. Mirëpo, në të njëjtën kohë shërbimet komunale duhet të jenë në gjendje të matin flukset dykahore të energjisë elektrike (shih më poshtë te Kutia 5 për më shumë informacion).

Thënë në përgjithësi, janë dy opsione: 1) **rregulloret mund të kërkojnë nga të gjithë prosumatorët me sisteme FV në lokacion të konsumatorit të instalojnë njëshorë që lejojnë si matjen e flukseve dykahore të energjisë elektrike ashtu edhe matjen e prodhimit bruto të sistemit diellor FV, ose 2) në vend të kësaj, rregulloret mund të imponojnë detyrimin ndaj shërbimeve komunale, duke u kërkuar atyre që të adoptojnë infrastrukturën matëse që lejon si matjen e flukseve dykahore të energjisë elektrike ashtu edhe matjen e prodhimit bruto.** Sidoqoftë, meqenëse kjo infrastrukturë matëse plotësuese rezulton me kosto shtesë, qoftë për prosumatorin ose për shërbimin komunal, nevojitet një formulë ose aranzhim i qartë për ndarjen e kostos.

Varësisht nga aranzhimet e caktimit të çmimeve të dakordësuara për prosumatorët, mund të kërkojnë njëshorët për kohën e shpenzimit.

Përgjegjësitë e balancimit

Sipas nenit 22 të Ligjit nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike në Kosovë, Operatori i Sistemit të Transmisionit (OST) është posaçërisht përgjegjës për organizimin dhe zhvillimin e tregut të balancimit të energjisë elektrike.²⁰ Si pjesë e ruajtjes së balancës në sistem në kohë reale, pjesëmarrësit e tregut kërkojnë t'ia japin OST-së informacionin e nevojshëm.

Në nivelin e BE-së, rregulloret aktuale në lidhje me përgjegjësitë e balancimit përcaktojnë një përjashtim për projektet nën 400kW. Ky prag parashikohet të bjerë në 200kW për projektet e kyçura në rrjet pas vitit 2026.²¹ Ndërkohë, prosumatorët me projekte të energjisë së ripërtëritshme në lokacion të konsumatorit nën 400kW nuk ballafaqohen me përgjegjësi të veçanta për balancim.

Mjedisi financiar

Në përgjithësi, bizneset përballen me një mjedis të vështirë financiar nëse dëshirojnë të investojnë në projekte për gjenerimin e shpërndarë nga burimet diellore FV. Normat e larta të interesit dhe mungesa e kredive për investime janë ndër pengesat kryesore financiare. Bankat vendase ofrojnë vetëm rreth 30-35% të kostos së nevojshme për investime në formën e kredive, me periudhë kthimi deri në 10 vjet dhe me normë interesi prej të paktën 5% - dhe shumica e investitorëve i financojnë projektet e tyre me ekuitet vetjak.²² Në përgjigje ndaj kësaj, institucionet e Kosovës, në vitin 2016 adoptuan Ligjin nr. 05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë. Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë është krijuar për të ndihmuar në përmbushjen e nevojës për rritje të qasjes në financa për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në Kosovë, me qëllim të krijimit të vendeve të punës, rritjes së prodhimit vendor dhe shërbimeve me vlerë të

²⁰ Republic of Kosovo, (2016), Law No. 05/L-085 on Electric Energy, Article 3, available at <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=12744>

²¹ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32019R0943&from=EN>

²² Govori, Zana, (2019), Renewable Energy in the Republic of Kosovo: Regulatory and Financial Obstacles to RES Penetration and Deployment in the Market, Thessaloniki: International Hellenic University


shtuar, përmirësimet të bilancit tregtar dhe për të zgjeruar mundësitë e financimit për NMVM-të.

Disa nga bankat kryesore në Kosovë kanë dhënë kredi të veçanta – kredi të gjelbëra. ProCredit Bank ofron “Kredi për Eko Investime” duke përfshirë investimet për gjenerim të shpërndarë nga burimet diellore FV. Nga TEB Bank në bashkëpunim me BERZH ofrohet “Kredia e Gjelbër” për investime që përfshijnë investimet për gjenerim të shpërndarë nga burimet diellore FV.

Përveç subvencionit të BERZH-it për kreditë e bankës TEB, nuk ka asnjë informacion publik për ndonjë avantazh tjetër që e ofrojnë këto “kredi të gjelbëra”. Përkundrazi, biznesi ose individit para së gjithash duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për të qenë të pranueshëm për të marrë kredi.


5. Sinteza dhe rekomandimet

Për të rritur nivelin e investimeve në projekte diellore FV, për të rritur efikasitetin e tyre dhe për të mirëmbajtur decentralizimin e sistemit të energjisë duke promovuar energjinë e ripërtëritshme në shkallë të vogël, përfshirë projektet diellore FV, duhen të ndërmerren një sërë masash.



Qeveria e Kosovës duhet të zotohet për tranzicion të plotë dhe të përshpejtuar të energjisë brenda një afati kohor specifik.

Strategjia e Energjisë e Kosovës 2017-2026 nuk e përmend tranzicionin e energjisë as si objektiv as si synim që duhet të arrihet. Duke i ditur synimet afatgjata të BE-së për dekarbonizimin, dhe duke marrë parasysh që prodhimi i energjisë elektrike me djegie të thëngjillit dhe linjitet nuk do të jetë më opsion pasi Kosova të hyjë në BE, Strategjia e Energjisë duhet të ndryshohet për të përfshirë politika të qarta për mbështetjen e projekteve për energji të ripërtëritshme diellore FV me një objektiv të qartë për tranzicionin e energjisë. Strategjia gjithashtu do të duhej të përfshijë prosumatorët dhe masat specifike për t'i mbështetur ata. Mungesa e një Strategjie gjithëpërfshirëse ka rezultuar në politika që përqëndrohen vetëm në ndërtimin e kapaciteteve të reja të thëngjillit dhe jo në tranzicionin e energjisë. Duke i marrë parasysh rezultatet e ankandit të kohëve të fundit për energji diellore nga Shqipëria fqinje, me nën 25 EUR / MWh, mund të pritët që përkushtimi politik për energjinë e rinovueshme dhe në mënyrë të veçantë për PV diellore do të vazhdojë të rritet në vitet e ardhshme.



Për të inkurajuar investimet e konsumatorëve prodhues, në Kosovë do të duhej të favorizohet qasja FIT-Neto në vend të politikës aktuale për Matje Neto..

Sipas hisedarëve të pranishëm në punëtori, disa konsumatorë tregtarë dhe industrialë tashmë po investojnë në sisteme diellore FV të instaluar në lokacion për vetë-konsum. Kjo sugjeron fuqimisht që investimi në projekte diellore me montim në çati është tashmë tërheqës për konsumatorët nga kategoritë e caktuara të nivelit të konsumit.

Përvoja në një numër në rritje të vendeve të botës sinjalizon largimin nga Matja Neto klasike drejt politikave të tjera të vetë-konsumit siç është **Faturimi Neto** (ku lejohet kreditimi monetar dhe mund të bartet për të kundër-balancuar konsumin në të ardhmen) si dhe **FIT-Neto** (ku paguhet gjenerimi i tepërt neto, qoftë në fund të çdo cikli të faturimit ose në fund të vitit).

Matja Neto krediton tërë energjinë elektrike të tepërt neto në bazë një-me-një në faturën e energjisë elektrike të konsumatorëve: prandaj transaksioni barazohet në kWh, jo në terma monetarë. Përveç kësaj, Matja Neto shpërfill kostot e rrjetit dhe të lidhura me transaksionet, duke e bërë atë më të kushtueshme për shërbimet komunale dhe për paguesit e tjerë të normës.

Në kuptim të mobilizimit të financimit bankar tradicional (d.m.th. kredive), Matja Neto paraqet një sërë sfidash, meqë kompensimi i marrë për gjenerimin e tepërt neto të projektit është në formën e kreditimit me kWh. Si rezultat, bankat nuk mund të jenë të sigurta se projekti do të paguhet, veçanërisht nëse biznesi që bëri investimin fillestar diellor falimenton. Mungesa e qartësisë rreth asaj që ndodh me sistemin diellor FV në lokacion të konsumatorit pas falimentimit rrit riskun e lëshimit të kredive në kushte të tilla. Prania e qasjes së qartë në treg për gjenerimin e tepërt të ofruar në rrjet paraqet "skenar të rastit më të keq" për bankën, dhe kështu, ndihmon në de-riskimin e investimeve të tilla.


Së këndejmi, në drejtim të inkurajimit të prosumatorëve në Kosovë, do të duhej të favorizohet qasja FIT-Neto në vend të politikës aktuale të vendit për Matje Neto: FIT-Neto lejon që prosumatorët të paguhet për gjenerimin e tepërt neto në fund të çdo cikli faturimi, ose viti kalendarik, sipas normës specifike. Në një numër në rritje të rasteve, kjo normë është më e ulët se norma e plotë për kWh që paguhet nga konsumatorët.

Sa i përket normave të kompensimit, ekzistojnë pesë mundësi themelore. Çmimi për gjenerimin e tepërt neto mund të caktohet:

1. **lidhur me tregun në kohë reale** (megjithëse kjo do të kërkonte njehsorë të kohës së përdorimit për të gjithë konsumatorët dhe ka gjasë të paraqesë pengesë shtesë për klientët shtëpiakë dhe konsumatorët e vegjël komercialë);
2. **lidhur me tregun, por bazuar në mesataret ditore, mujore ose vjetore;**
3. **lidhur me komponentin energjetik të normës së shitjes me pakicë**, minus një tarifë e vogël, ose përqindje, për të mbuluar kostot e transaksionit dhe marzhën e furnizuesit (p.sh. 10-15%);
4. **Bazuar në ndonjë normë tjetër, siç janë kostot e energjisë të shmangura nga furnizuesi**, që rishikohen dhe azhurnohen me kalimin e kohës;
5. **Bazuar në ndonjë formulë tjetër, siç është vlera e energjisë diellore** në rrjetin e shpërndarjes, pasi të jetë marrë parasysh koha e ditës, reduktimi i humbjeve të linjës, vlera e energjisë dhe kapacitetit, etj.


Secili prej këtyre opsioneve të ndryshme ka implikime të rëndësishme si për shërbimet komunale (d.m.th. blerësit), ashtu edhe për prosumatorët.

Siç u theksua më lart, një formulë e caktimit të çmimit që lejon që konsumatorët të **paguhet** për gjenerimin e tyre të tepërt neto (në vend se thjesht të marrin kreditim në faturim), edhe nëse është krijuar me një normë relativisht të ulët siç është çmimi i tregut, mund të jetë kritike për të ndihmuar mobilizimin e financimit.




Është e nevojshme reforma rrënjësore e sistemit të lejeve dhe liçencave.

Qeveria e Kosovës do të duhej të krijojë një sistem 'one-stop-shop' për dhënien e liçencave dhe lejeve. Ky sistem i lejeve dhe liçencave do të duhej të sigurojë që investitorët të informohen për shërbimet, kushtet dhe të gjitha institucionet përgjegjëse. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, komunat dhe agjensitë e tjera duhet të punojnë së bashku për të krijuar sistemin 'one-stop-shop' për të gjitha lejet.




Kufiri aktual prej 100 kW për prosumatorët do të duhej të rishqyrtohet.

Një model për t'u marrë parasysh është ai i Shqipërisë ku kufiri është 500 kW (me kusht që rryma që gjenerohet nga sistemi i instaluar diellor është më e paktë ose baraz me sasinë vjetore që i nevojitet konsumatorit prodhues) dhe bazohet në modelet e konsumit të prosumatorëve. Ndryshimi i këtij kufiri do të kontribuonte në rritjen e investimeve, veçanërisht nga konsumatorët që paguajnë tarifa më të larta, duke rezultuar në prodhim më të decentralizuar.



Asnjë detyrim specifik i balancimit nuk do të duhej të imponohet për prosumatorët individualë.

Duke pasur parasysh që shumica e projekteve diellore FV të konfiguruar për vetë-konsum ka gjasë të mbeten relativisht të vogla në Kosovë (më pak se 500kW), aktualisht nuk ka nevojë të imponohet përgjegjësia individuale e balancimit për secilin prosumator. Këto përgjegjësi të balancimit mund të transferohen te Pala Përgjegjëse e Balancimit në mënyrë që të ruhet stabiliteti i sistemit për të ardhmen e parashikueshme.




Training is needed for municipal officials on renewable energy in general and specifically for solar PV projects.

These trainings should focus not only on issuing municipal approval documents necessary to obtain a license for building projects, but also on how to integrate solar PV projects into municipal development strategies and municipal regulatory plans.




Është i nevojshëm trajnimi për zyrtarët komunalë për energjinë e ripërtëritshme në përgjithësi dhe për projektet diellore FV në veçanti.

Këto trajnime do të duhej të përqendrohen jo vetëm në lëshimin e dokumenteve të miratimit komunal të nevojshme për të marrë liçencë për ndërtimin e projekteve, por edhe për mënyrën e integritit të projekteve diellore FV në strategjitë e zhvillimit komunal dhe planet rregulluese komunale.




Duhet të rritet kapaciteti njerëzor brenda institucioneve përgjegjëse, veçanërisht në Zyrën e Rregullatorit për Energji dhe në komuna.

Ka mungesë të personelit të mjaftueshëm për t'u marrë me projektet e energjisë së ripërtëritshme (FV). Shtimi i personelit në këto institucione do të ndihmonte në përshejtimin e implementimit të projekteve dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për investitorët.



Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës duhet të sigurojnë që vendi ka institucione të qëndrueshme, të pavarura dhe funksionale.

Duhet të ndryshohet mënyra si zgjedhen anëtarët e Bordit të Rregullatorëve ashtu që Rregullatori të mos mbetet jofunksional për shkak se shumica e anëtarëve të tij nuk kanë mandat. Më e rëndësishmja, kriteret për emërimin e këtyre anëtarëve do të duhej të ndryshojnë në favor të rritjes së profesionalizmit, në vend që të bazohen në përkatësinë partiake dhe në politizim.



Institucionet e Kosovës do të duhej të punojnë për të përmirësuar mjedisin financiar për projektet.

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore do të duhej të punojë me institucionet financiare në Kosovë për t'i dhënë prioritet projekteve të energjisë diellore. Ky Fond garanton 50% të kolateralit dhe është jashtëzakonisht i rëndësishëm për lehtësimin e investimeve. Përveç kësaj, Banka Qendrore e Kosovës do të duhej të forcojë masat nxitëse për bankat në mënyrë që të ulen normat e interesit për projektet diellore FV.

